



Republika e Kosovës

Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 386/2020

Datë: 31 gusht 2020

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 31 gusht 2020 KPK/Nr. 385/2020 shpall:

SHPLLJE E BRENDISHME

- I. Për plotësim me tre (3) pozita për prokurorë në Prokurorinë e Apelit.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:
 1. Të kenë së paku pesë (5) vite përvojë si prokuror, prej të cilave tre (3) vite përvojë si prokuror në Departamentin e Specializuar të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës të Kosovës si dhe bazuar në vlerësimin e performancës;
 2. Të kenë mandat të përhershëm;
 3. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit dhe vërejtjes jo publike me shkrim;
 4. Pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhen me procedurën penale, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merren parasysh.
- III. Kandidati që parashtron kërkesë duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:
 1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;

3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 07 shtator 2020 deri më datë 21 shtator 2020.

VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e pestë (5) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 505, të mbyllura në zarf, ose me postë.